



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 175 dt.26.08.1994

**PER**  
**REZULTATET E KONTROLL – REVIZIONIT EKONOMIKO – FINACIAR**  
**TE KRYER NE ND/JEN E PARKUT AUTOMOBILISTIK TE MALLRAVE.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.27.08.1994, shqyrtoi njoftimin e përgatitur nga Drejtoria e Administrimit Financës e Kontroll – Revizionit “Për rezultatet e kontroll – revizionit ekonomik - financiar të kryer në Ndërmarrjen e Parkut Automobilistik të Mallrave” .

Vëren se :

Puna e kryer për ruajtjen dhe administrimin e vlerave materiale dhe monetare nga drejtuesit e ndërmarrjes është bërë me të meta, dobësi, ka munguar organizimi, drejtimi dhe kontrolli financiar ka qënë i dobët.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Këshilli Bashkiak

**VENDOSI**

1. Likuidatori i ndërmarrjes të marrë masa për zbatimin e detyrave të lëna nga ekipi i kontrollit duke ngarkuar me përgjegjësi shkaktarët.

2. Në mbështetje të ligjit Nr.7526, dt.03.12.1991, pika.”b” dhe “d”, “Për marrdhëniet e punës” drejtorit të ndërmarrjes Z. Vangjush Dallto i hiqet vërejtje me para lajmërim, për paaftësi në detyrë dhe veprime të parregullta në administrimin e dokumentimin e vlerave materiale dhe monetare.
3. Ti propozohet ndërmarrjes që Kryetares së Degës së Financës Z. Fatbardha Hasani, ti jepet vërejtje për veprime të parregullta të kryera në administrimin e pronës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Parku Automobilistik i Mallrave, Drejtoria e Ndërtimit dhe Shërbimit Publik dhe Seksioni i Organizimit dhe Drejtoria Administrimit Financiar dhe Kontroll – Revizionit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**